



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Hapet thirrja për projekt-propozime në Art&Kulturë&Trashëgimi për vitin 2018

2017-12-04 14:00:00



Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre projekt-propozime në Art, Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor për vitin 2018. Kjo thirrje bazohet në vizionin e programit të MK, duke patur parasysh strategjitë: Edukimi përmes kulturës; Trashëgimia Kulturorë- motor zhvillimi; Mbështetje e skenës së pavarur artistike. Fondi i

Ministrisë së Kulturës në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të mbështesë projekte që propozojnë ide dhe sjellin risi në : • Projekte të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore; • Projekte në funksion të turizmit kulturor bregdetar; • Projekte në kuadër të “Viti i Skënderbeut”; • Projekte në kuadër të Vitit të Trashëgimisë Kulturore Europiane; • Projekte kulturore digjitale; • Projekte të industrive kreative; Ky fond shkon për projekte që zhvillohen ekskluzivisht ose kryesisht në Shqipëri. Propozim-projektet e paraqitura duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, që do të thotë se aktivitetet e propozuara duhet të zhvillohen brenda periudhës 20 shkurt - 5 dhjetor të vitit 2018.

Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre projekt-propozime në Art, Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor për vitin 2018.

Kjo thirrje bazohet në vizionin e programit të MK, duke patur parasysh strategjitë: Edukimi përmes kulturës; Trashëgimia Kulturorë- motor zhvillimi; Mbështetje e skenës së pavarur artistike. Fondi i Ministrisë së Kulturës në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të mbështesë projekte që propozojnë ide dhe sjellin risi në :

- Projekte të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- Projekte në funksion të turizmit kulturor bregdetar;
- Projekte në kuadër të “Viti i Skënderbeut”;
- Projekte në kuadër të Vitit të Trashëgimisë Kulturore Europiane;
- Projekte kulturore digjitale;
- Projekte të industrive kreative;

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen ekskluzivisht ose kryesisht në Shqipëri. Propozim-projektet e paraqitura duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, që do të thotë se aktivitetet e propozuara duhet të zhvillohen brenda periudhës 20 shkurt - 5 dhjetor të vitit 2018.

Thirrja për projekt-propozime e Ministrisë së Kulturës për vitin 2018, hapet ditën e hënë, datë 4 dhjetor 2017 dhe përfundon ditën e premte, datë 12 janar 2018, në orën 12:00. Përzgjedhja përfundimtare shpallet nga kolegji në datën 15 shkurt 2018.

Ju falenderojmë për besimin,
Ju garantojmë bashkëpunim profesional në idetë dhe projektet që

do të prezantoni.
Suksese të gjithë pjesëmarrësve!